



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT
DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Nr. 416 Prot.

Tiranë, më 25.02.2022

AKT PËRPUTHSHMËRIE
PËR DOKUMENTIN E RISHIKIMIT TË
PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR
BASHKIA TROPOJË

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 9 dhe pikës 3 të nenit 23 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" i ndryshuar, të VKM Nr. 686, datë 22.11.2017 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", e ndryshuar, të përcaktimeve të Planit të Përgjithshëm Kombëtar, të Vendimit Nr. 2, datë 09.12.2017 të KKT-së "Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor Bashkia Tropojë", të Vendimeve të Këshillit Kombëtar të Territorit lidhur me përcaktimin e çështjeve, shpalljen e zonave dhe objekteve të rëndësisë kombëtare në planifikim, të Strategjive Sektoriale në fuqi, të normave teknike të planifikimit, të dhënave elektronike bazë si dhe Raporit të Vlerësimi Teknik, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit,

VENDOSI:

1. Lëshimin e Aktit të Përputhshmërisë për Dokumentin e Rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Tropojë.
2. Akti i Përputhshmërisë lëshohet me kusht që, përpara miratimit të dokumentit të rishikimit në Këshillin Kombëtar të Territorit, bashkia, në zbatim të Ligjit Nr.91/2013 "Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor", të presë qëndrimin nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (se rishikimi i Planit të Përgjithshëm Vendor nuk ka nevojë t'i nënshtrohet procesit të VSM-së).

ADELINA GRËCA

DREJTORE E AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

